



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 144 Prot.

Tiranë, më dt. 21. 03.2018

**VENDIM**

**Nr.120, dt. 21.03.2018**

Në mbështetje të nenit 47 të Ligjit nr.9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 21.03.2018, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e projektit “Ndërtim i burimit rigjenerues të Energjisë, Hydrocentrali “PREVALLI”, në përroin e Zallit të Kostenjës, degë e Zallit të Lunikut me derdhje në lumin Shkumbin, fshati Prevalli, Bashkia Librazhd, Qarku Elbasan”, me subjekt aplikues shoqëria “GEGA-G” sh.p.k..
2. Shoqëria të kontribuojë për restaurimin e objektit monument kulture: “Ura e Kamarës”, Mirakë, Librazhd, Qarku Elbasan.
3. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të **mbikëqyren** sipas nenit 48 të ligjit nr. 9048, dt. 07.04.2003 “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



**KRYETAR**

Mirela Kumbaro Furxhi

**SEKRETAR I KKR**

Arta Dollani